



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamentit i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al;

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____

V E N D I M

Nr. ____, Datë _____

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MIRDITË MBI AUDITIMIN E
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 30.09.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Mirditë, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit. Për periudhën objekt i auditimit u konstatuan dhe të meta e dobësi me pasoja financiare në drejtim të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për punë publike.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë të ushtruar në Bashkinë Mirditë, sipas programit të auditimit nr. 936/1 prot., datë 01.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri në 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Buxhetet janë miratuar jashtë afateve ligjore, pasi duhej të miratoheshin para mbylljes së viteve paraardhës. Është respektuar limiti i shpenzimeve mujore në masën 1/12 e shpenzimeve të viteve të mëparshme sipas kërkesave të ligjit të buxhetit, por miratimi me vonesë i buxheteve, për vitin 2016 sipas VKB nr. 48, datë 30.03.2016 dhe VKB nr. 3, datë

25.01.2017, është në kundërshtim me nenin 32, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor” të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore të të gjitha niveleve paraqesin për miratim buxhetet e këshillave të tyre. Këshilli i qeverisjes vendore brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vendor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për përgatitjen e treguesve të buxhetit për vitet buxhetore para fillimit të viteve ushtrimore, përgatitjen dhe propozimin në Këshillin Bashkiak në afate të përcaktuara me qëllim bërjen efektiv të buxhetit në fillim të vitit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Treguesit e PBA për vitet 2017-2019, janë përgatitur nga sektorët dhe zyrat brenda afateve ligjore dhe të analizuar për të ardhurat dhe shpenzimet, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 4/1, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, por nuk është miratuar kalendari i veprimeve dhe nuk janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura krahasimisht (Buxheti afatmesëm me buxhetin vjetor) dhe analizimi i shkaqeve për ndryshimet e ndodhura, për të shmangur formalizimin në hartimin e treguesve të PBA-së. Nga verifikimi i realizimit të treguesve të buxhetit, për çdo muaj dhe në mbyllje të viteve buxhetore u konstatua se gjatë vitit nuk është marrë në analizë buxheti i bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 47, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Urdhërues dhe Nëpunësi Zbatues në bashki të merren masa për menaxhimin e veprimtarisë të grupeve të punës (Drejtoritë dhe sektorët) për krahasimin e treguesve të buxhetit afat mesëm me ato të buxheteve vjetore duke analizuar dhe shkaqet e ndryshimeve, si dhe të merren masa për kryerjen e analizave të treguesve financiarë për çdo muaj.

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi: Nga toka bujqësore e pa ndarë nuk është dhënë me qira tokë bujqësore. Bashkia Mirditë nga fondi i tokës bujqësore të trashëguar nga ish - Kooperativat Bujqësore dhe ish - Ndërmarrjet Bujqësore aktualisht ka tokë të pandarë në sasinë prej 2383 ha. Për sipërfaqen e pandarë nuk ka toka të dhëna me qira dhe nga bashkia nuk disponohet lista e parcelave të pa ndara për ish - komunat e detajuar rast pas rasti. Në këto kushte toka bujqësore e pa ndarë nuk administrohet nga bashkia. Përveçse tokat kryesisht janë të zëna nga individë të ish – komunave, nga bashkia nuk është bërë identifikimi i individëve që e përdorin tokën bujqësore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për ngritjen e grupeve të punës për saktësimin e sipërfaqeve të parcelave të tokës bujqësore të pa ndarë. Te saktësohet numri i individëve që aktualisht e përdorin sipërfaqen prej 2383 ha dhe të merren masa ligjore për ndërprerjen e përdorimit të tokës bujqësore pa kontrata qiraje.

Mbrenda 6-mujorit të parë, 2019

4. Gjetje nga auditimi: Në bazë të dokumentacionit që ka mbajtur Policia Bashkiake nga data 01.01.2016 deri më datë 30.09.2018 rezulton se është hartuar libri i shërbimit të policisë, por në librin e shërbimit nuk janë pasqyruar konstatimet e rezultuara gjatë shërbimeve përveç 19 rasteve të dokumentuara nga të cilat, 14 raste, akte kontrolli dhe, 5 raste proces-verbale. U konstatua

gjithashtu se nga aktiviteti i Policisë Bashkiake për periudhën e audituar mungon bashkëpunimi me Drejtorinë e të Ardhurave të Bashkisë për realizimin e të ardhurave të programuara nga bizneset, për ushtrim aktiviteti pa u regjistruar nga biznesi i vogël, për shlyerjen e detyrimeve brenda afateve ligjore etj. Gjithashtu nuk është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm për kontrollin e ushtruar për ndërtimet pa leje nga individë të veçantë dhe ka munguar bashkëpunimi me IMTV e Bashkisë Mirditë. Këto veprime bien në kundërshtim me dispozitat ligjore për administrimin e territorit të Bashkisë Mirditë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Mirditë të merren masa për ndjekjen e veprimtarisë të Policisë Bashkiake në funksion të rritjes së efektivitetit të kësaj strukture në drejtim të administrimit të aseteve, të tokave bujqësore të pa ndara pronë e bashkisë, ndërtimeve pa leje dhe të kontrollit të bizneseve të parregullt për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për ish - Komunitat Kaçinar, Fan, Selitë dhe Kthellë nuk është plotësuar dokumentacioni përfundimtar dhe për pasojë nuk janë miratuar me VKM përfundimtare kalimi i pronave në Bashkinë Mirditë, por janë me VKM që ju referohen listave paraprake të ish Komunitave e konkretisht: Njësitë Administrative Kaçinar për 440 prona, Fan për 1017 prona, Selitë për 664 prona dhe Kthellë për 505 prona. Në këto kushte nga Bashkia Mirditë duhej të ishin ndjekur procedurat për evidentimin e ndryshimeve që kanë pësuar pronat nga vendimet paraprake të Këshillit të Ministrave para reformës administrative për ish- komunitat që nuk kanë përfunduar procedurat për miratimin e kalimit përfundimtar të pronave në pronësi dhe administrim të bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të analizohet situata e krijuar duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse dhe të merren masa për evidentimin dhe kontrollin në terren të pronave që ju përkasin trojeve dhe ndërtesave të ish- Komunitat Kaçinar për 440 prona, Fan për 1017 prona, Selitë për 664 prona dhe Kthellë për 505 prona dhe të hartohen listat përfundimtare për në Këshillin e Bashkisë dhe të propozohet në Këshillin e Ministrave për kalimin përfundimtar në pronësi të Bashkisë Mirditë.

Mbrenda 6-mujorit të parë, 2019 6. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të bilancit të vitit 2017 dhe të 9-mujorit të vitit 2018 trashëgohen detyrime të prapambetura për 2363 raste në vlerën prej 34,899,300 lekë, që ju përkasin detyrimeve nga taksat dhe tarifave vendore . *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Taksave, Menaxhimit të Tregut, Transportit dhe Aseteve të merren masa duke hartuar program masash për vjeljen e detyrimeve të prapambetura që ju përkasin taksave dhe tarifave vendore sipas të dhënave të 9-mujorit të vitit 2018 në shumën prej 34,899,300 lekë me 2363 persona të parregullt në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Kjo vlerë është paraqitur si kundërpadi në pasiv të bilancit në rreshtin 35, “Kreditor” dhe duhet sistemuar në llogarinë nr. 475,”Të ardhura për tu arkëtuar”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në formularin nr. 1 “Aktivi i bilancit kontabël” për vitin 2016 dhe vitin 2017 në rreshtin 68, llogaria nr. 85, “Rezultati i ushtrimit (saldo debitor)” është paraqitur me tepriçë debitor në vlerën 18,732,634 lekë, ndërsa në vitin 2017 me vlerë 44,181,849 lekë. Në të dy rastet “për mjete në ruajtje” dhe llogaria 85 “rezultati i ushtrimit” është paraqitur në aktiv dhe në pasiv të bilancit. Këto veprime janë kryer ekstra kontabël dhe kanë prishur rezultatin e bilancit (Është paraqitur në debi dhe në kredi) në kundërshtim me udhëzimin për mbylljen e llogarive vjetore). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit të merren masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës 44,181,849 lekë, përse është paraqitur gabimisht në llogarinë nr. 85, “Rezultati i ushtrimit (saldo debitorë)” për vlerën e mësipërme, paraqitur në bilancin e vitit 2017.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në njësitë administrative Fan, Kthellë, Rubik dhe Rrëshen nga komisionet e inventarizimit të vitit 2016, janë konstatuar 4 mjete jashtë përdorimit në vlerën 5,757,500 lekë kurse në vitin 2017, janë konstatuar jashtë përdorimit 3 (tre) mjete në vlerën 8,828,916 lekë. Gjithsej për të dy vitet janë konstatuar jashtë përdorimit 7 (shtatë) mjete në vlerën 14,586,416 lekë dhe nuk janë zhvilluar procedura të mëtejshme për tjetërsimin e këtyre mjeteve, nuk është realizuar grumbullimi i tyre për arsye ambienti, si dhe nuk është ngritur komisioni me specialistë të fushës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për grumbullimin e 7 (shtatë) mjeteve në vlerë 14,586,416 lekë të konstatuara jashtë përdorimit për vitet (2016, 2017) nga komisionet e inventarizimit dhe njëkohësisht të ngrihet grupi i punës me specialist të fushës (ing. mekanik) për vlerësimin dhe tjetërsimin e tyre referuar dispozitave ligjore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar e Buxhetit dhe Drejtoria e të Ardhurave, Taksave, Menaxhimit të Tregut, Transportit dhe Aseteve, nuk është hartuar rregullore e veçantë për përdorimin nga nëpunësit të programeve informatike si dhe nuk janë përcaktuar personat që kanë të drejtë të përdorin sistemin si dhe nivelet e aksesit për këto persona. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i bashkisë, për të rritur shkallën e sigurisë të hedhjes dhe ruajtjes të dhënave të kontabilitetit dhe të ardhurave në sistem, të autorizohen personat në varësi të proceseve dhe operacioneve të punës mbështetur në rregullore të veçantë për përdorimin sistemit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, u konstatua se dokumentacioni për subjektet që ushtrojnë aktivitet privat në territorin e Bashkisë Mirditë, aktualisht ndodhet në çdo njësi administrative. Kjo bie ndesh me përcaktimet në VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Bashkia Mirditë, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM-në dhe Udhëzimin e mësipërm, pasi në njësitë administrative mund të qëndrojnë kopje të këtij dokumentacioni, por gjithsesi, njësitë e dokumentacionit origjinal duhet të depozitohen pranë arkivit të bashkisë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Mirditë nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP të rrethit, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar. *(Më*

hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)**11.1. Rekomandimi:** Bashkia Mirditë të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Mirditë, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Mirditë. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Bashkia Mirditë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM përkatëse dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP të rrethit, në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trulli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mirditë nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Mirditë nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të përshkuara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim, rezulton se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Rekomandimet sa vijojnë, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mirditë, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

- a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e bashkisë në vijimësi.
- b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektiv prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar

dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

Menjëherë

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshëm dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **9,881,536 lekë** nga të cilat: 8,726,523 lekë në zbatimin e kontratave për punë publike dhe, 1,155,013 lekë në fushën e administrimit financiar dhe lejet e ndërtimit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 9,881,536 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Kontratat qirasë me kompaninë “██████████” ShPK me shumë detyrimi të pa përfshirë në kontabilitet 98,000 lekë që ju përkasin: Antena të vendosura në pikat “Nënshjet” 35,000 lekë, “Lurth” 29,300 lekë, Fanë Thirre 33,700 lekë, si rezultat i mbylljes së kësaj kompanie, përbën dëm ekonomik. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5 faqe 105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga kontrata e qirasë të pa regjistruara në kontabilitet në ngarkim të kompanisë “██████████”, në vlerën **98,000 lekë**.

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

2. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e lidhur midis Bashkisë Mirditë dhe subjektit privat “██████████” datë 18.08.2016, me afat 10 vjet, detyrimi vjetor për vitin e dytë të kontratës (Datë 18.8.2017 – 18.8.2018 e në vazhdim) është ulur nga 1,142,042 lekë në 39,485 lekë, ku në fakt sipas raportit teknik vlera e kontratës për vitin e dytë duhet të jetë 975,010 lekë.

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 5 faqe 105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për ndryshimin e vlerës së kontratës të lidhur me “██████████”, mbështetur në raportin teknik, ku është përcaktuar vlerën 975,010 lekë/vit dhe njëkohësisht të merren masa për shlyerjen e detyrimit të prapambetur për **935,525 lekë** që i përket vitit të dytë të kontratës (nga data 18.08.2017-18.08.2018).

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt “Sistemim-Asfaltim rruge Klos-Gjakëz-Domgjon, Nj.A. Fan, Faza I”, Bashkia Mirditë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë shoqërisë “██████████”

SHPK, u konstatua se për zërat e punimeve: Gërmim dhe me eskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi > 2 m, tok zak, Kateg IV. me shkark në tokë; F.V Hekur betoni periodik Ø > 10 mm (mure mbajtës + shpatulla + mure pritës); Gabion me rrjetë teli 1x1x1 m (Mbrojtja nga lumi, l=204 ml); Struktura monolite betoni C 25/30, për mure mbajtës + shpatulla tombinosh; Tombino me tuba betoni Ø 1000 mm, mbi shtresë betoni, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 922,723 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, Pika 3 si dhe me kontratën e lidhur me datë 11.05.2017 dhe me nr. prot. 9175.

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 faqe 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për kompensimin e vlerës prej **922,723 lekë pa TVSH** nga OE “██████████” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Sistemim-Asfaltim rruge Klos-Gjakëz-Domgjon, Nj.A. Fan, Faza I”, Bashkia Mirditë, nëpërmjet realizimit të zërave të punimeve që rezultojnë me diferenca sipas analizës së trajtimit në Raportin Përfundimtar të auditimit duke qenë se ekzistojnë mundësitë fizike objektivist.

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt “Zgjatim i unazës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë shoqërisë “██████████” SHPK, u konstatua se për zërat e punimeve: Gabiona me rrjetë teli të zinkuar e gurë kave 1x1x1 m; Fugë me gomë speciale me kanal të gjerë në ura dhe zëri F.V Tabela rrugore të ndryshme D=90 cm, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 5,338,620 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, Pika 3, si dhe me kontratën e lidhur me datë 08.05.2017 dhe me nr. prot. 2084.

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 faqe 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për kompensimin e vlerës prej **5,338,620 lekë pa TVSH** nga OE “██████████” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me objekt “Zgjatim i unazës së qytetit Rrëshen” Bashkia Mirditë, nëpërmjet realizimit të zërave të punimeve që rezultojnë me diferenca sipas analizës së trajtimit në Raportin Përfundimtar të auditimit duke qenë se ekzistojnë mundësitë fizike objektivist.

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Rrëshen”, Bashkia Mirditë, me vlerë të kontratës 172,020,124 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik “██████████” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 2,465,180 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4182 prot datë 13.07.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe Operatorit Ekonomik “T██████████” SHPK. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 faqe 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,465,180 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “██████████” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4182 prot., datë 13.07.2016 me objekt “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit

Rrëshen”, Bashkia Mirditë, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

6. Gjetje nga auditimi: Në lejen e ndërtimit të miratuar për subjektin [REDAKTUAR], i cili ka aplikuar për leje ndërtimi deri në 250 m², nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekti i miratuar i Studios Projektuese përcakton sipërfaqen prej 187 m² për kat x 2 kate ndërtim = 374 m² ndërtim. Siç vihet re, ky ndërtim e kalon sipërfaqen prej 250 m² që përcakton Vendimi i KKT-së dhe është 124 m² më tepër. Kjo konstatohet edhe tek formati i aplikimit të subjektit, i cili nuk përcakton sipërfaqen totale të njollës së ndërtimit por përcakton sipërfaqen e përgjithshme të tij prej 250 m² dhe 2 kate për tu ndërtuar. Kjo bie ndesh me bazën ligjore të sipërcituar dhe gjithashtu subjekti ndërtues, nuk bëhet subjekt i pagesës së diferencës prej 124 m² të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 124 m² x 32,658 lekë x 0.03 = 121,488 lekë, e cila përbën dëm ekonomik (mungesë të ardhurash) për buxhetin e Bashkisë Mirditë. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 6 faqe 116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **121,488 lekë** nga subjekti [REDAKTUAR], në cilësinë e aplikuesit dhe përfituesit të lejes së ndërtimit në të cilën nuk është llogaritur dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për sipërfaqen prej 124 m².

Brenda 6-mujorit të parë, 2019

B/1. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

I. Gjetje nga auditimi: Në 6 procedura prokurimi me F.L. në vlerën 290,108,233 lekë pa tvsh, janë konstatuar parregullsi në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve sipas DST, jo duke u udhëhequr nga kërkesat në nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, shkronja (a, b, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, shkronja (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku evidentohet qartë se procedurat përputhen formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik por KVO dhe NJP nuk janë udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike. Mbështetur në vlerësimin e kërkesave për kualifikim, sidomos ato të veçanta, evidentohet fokus i KVO në vlerësim strikt të dokumenteve që plotësojnë kërkesat për kualifikim sidomos ato që mund të trajtohen lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” të cilat do të krijonin mundësinë e shpalljes fitues të OE me ofertë ekonomike më të ulët nga ofertat e shpallur fituese, me diferencë prej **25,867,151 lekë**, e cila përbën shpenzim jo efektiv dhe eficient të fondeve të prokuruar dhe, konkretisht:

1. Në tenderin me objekt “Rehabilitim i rezervuarit Malaj – 2 me skemë vaditëse (rehabilitim i pjesshëm”, në Bashkinë Mirditë, me fondin limit në shumën 17,166,100 lekë pa tvsh, zhvilluar më 29.04.2016, rezulton se është shpallur fitues OE “[REDAKTUAR]” SHPK me ofertën në shumën 16,120,579 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe eficientë vlera prej **694,700 lekë** e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit “[REDAKTUAR]” shpk në shumën prej 15,425,879 (16,120,579 - 15,425,879) për devijime të vogla që nuk cenojnë zbatimin e kontratës.

2. Në tenderin me objekt “Rehabilitim i Rrjetit ujitës të ujëmbledhësit Malaj – 2 (Vazhdim), Bashkia Mirditë”, me fondin limit në shumën 30,849,181 lekë pa tvsh, zhvilluar më 15.11.2016, rezulton se është shpallur fitues OE “██████████” SHPK me ofertën në shumën 30,072,422 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet vlera prej 5,085,112 lekë e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit OE “██████████” SHPK në shumën prej 24,987,310 (30,849,181 - 24,987,310) për devijime të vogla që nuk çenojnë zbatimin e kontratës.

3. Në tenderin me objekt “Ndërtim fushe sportive (kalçeto) shkolla e mesme Repe”, në Bashkinë Mirditë, me fondin limit në shumën 6,666,600 lekë pa tvsh, zhvilluar më 24.04.2017, rezulton se është shpallur fitues OE “██████████” shpk me ofertën në shumën 6,364,180 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet vlera prej 1,464,380 lekë e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit OE “██████████” shpk në shumën prej 4,899,800 (6,364,180 - 4,899,800) për devijime të vogla që nuk çenojnë zbatimin e kontratës.

4. Në tenderin me objekt “Godina e shërbimeve për qytetarët, Rrëshen, Bashkia Mirditë”, me fondin limit në shumën 82,477,353 lekë pa tvsh, zhvilluar më 21.11.2016, rezulton se është shpallur fitues OE “██████████” ShPK, me ofertën në shumën 75,897,852 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet vlera prej 5,659,846 lekë e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit OE “██████████” shpk në shumën prej 70,238,006 (82,477,353 - 70,238,006) për devijime të vogla që nuk çenojnë zbatimin e kontratës.

5. Në tenderin me objekt “Mbrojtje nga lumi Fan i vogël në fshatin Mashterkor, Bashkia Mirditë” me fondin limit në shumën 27,459,008 lekë pa tvsh, zhvilluar më 19.08.2016, rezulton se është shpallur fitues OE “██████████” ShPK, me ofertën në shumën 26,119,708 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet vlera prej 3,876,833 lekë e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit OE “██████████” shpk në shumën prej 22,242,875 (26,119,708 - 22,242,875) për devijime të vogla që nuk çenojnë zbatimin e kontratës.

6. Në tenderin me objekt “Zgjatim i unazës së qytetit Rrëshen”, në Bashkinë Mirditë me fondin limit në shumën 125,489,991 lekë pa tvsh, zhvilluar më 30.03.2017, rezulton se është shpallur fitues OE “██████████” ShPK, me ofertën në shumën 121,840,408 lekë pa tvsh dhe vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe efikasitet vlera prej 9,086,280 lekë e shkaktuar nga refuzimi i ofertës së operatorit OE “██████████” shpk në shumën prej 112,754,128 (121,840,408 - 112,754,128) për devijime të vogla që nuk çenojnë zbatimin e kontratës. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 4 faqe 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

I.1 Rekomandimi: Bashkia Mirditë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **25,867,151 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, nënëpërmjet shmangjes së arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomik të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Në vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh, si më poshtë:

1. “██████████” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Rrëshen”, Bashkia Mirditë, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik “██████████” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,465,180 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.
2. “██████████” SHPK, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Rrëshen”, Bashkia Mirditë, me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik “██████████” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,465,180 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R